

# ARSIMIMI NË PERIUDHËN MONISTE

## Intervistë

### (Prof. Fatime Beshiri, punimi i magistraturës)

1. *Cilët ishin rrethanat në të cilat zhvillohej arsimi shqip në nivel republikan në kohën e komunizmit kur Ju mësonin në shkollë të mesme dhe në fakultet, duke u nisur nga numri i nxënësve të interesuar, të punsuarve, politikat arsimore dhe kushtet e institucioneve shkollore?*

2. *Si trajtoheshin mësimdhënësit dhe prijësit fetar në kohën e komunizmit?*

3. *A mundë ta përshkruani arsimin shqip para dhe pas pamvarsisë së Maqedonisë, dhe si ndikonte politika në arsim?*

4. *Mendimi Juaj personal, si ndikon Politika sot në sistemin arsimor duke filluar nga shkollat fillore deri në atë sipërore?*

\*\*\*

1. *Cilët ishin rrethanat në të cilat zhvillohej arsimi shqip në nivel republikan në kohën e komunizmit kur Ju mësonin në shkollë të mesme dhe në fakultet, duke u nisur nga numri i nxënësve të interesuar, të punsuarve, politikat arsimore dhe kushtet e institucioneve shkollore?*

**B. Aliu:** mësimi në kohën e komunizmit, më mire të themi në ishjugosllavinë e Titos, juridikisht mësimi zhvillohej në suaza të Kushtetutës së vitit 1974. Kjo na jep të kuptojmë se mësimi për pakicat e ishjugosllavisë garantohej deri në shkollimin sipëror në gjuhën amtare. Shqiptarët e Maqedonisë si pakicë kombëtare nuk kishin mundësitë e shkollimit që i kishte Kosova si Krahinë Autonome, kuptohet me të drejta të cunguara në krahasim me gjashtë republikat tjera që ishin republika konstituive të Jugosllavisë së Titos.

Shkollimin e mesëm shqiptarët e Maqedonisë së athershme e bënë në gjimnazin e Tetovës, në gjimnazin e “Zef Lush Markut” në Shkup dhe në disa qytete tjera në mënyrë shumë të kufizuar. Pse them të kufizuar, them sepse politika e shtetit nuk lejonte që shqiptarët lirshëm të shkollohen, por numri I nxënësve që do të regjistroheshin në shkollat e mesme ishte shumë i vogël. Këtë e bënë me qëllim që shqiptarët të mos shkollohen në numër.

Vitet e tetëdhjeta ishin vitet më të rënda të shkollimit të shqiptarëve. Kuptohet pas demonstratave të vitit 1981, shteti në nivel federative dhe në nivel republikan veprimi në mënyrë shumë të egër, bile edhe kundër ligjeve që ekzistonin. Mirëpo, përkundër këtyre veprimeve të pushtetarëve shqiptarët ishin të gjindshëm dhe ata që kishin mundësinë dhe donin të shkollojnë fëmijët gjenin forma dhe mënyra. Por kuptohet se

për këtë nevojitej një angazhim shumë më u madhë në kuptim të gjetjes së lidhjeve, ryshfetit që u jepej pushtetarëve, lidhjeve “miqësore” dhe s’do mend se kishte një grup njerëzish të cilët ishin puthadorë të sistemit dhe të pushtetit, pra për këta nuk kishte vështirësi.

Për sa i përket shkollimit fetar, kuptohet se ishte i kufizuar tejmasë dhe vepronte vetëm medreseja e mesme e “Gazi Husrefbeut” në Sarajevë që ishte edhe e privilegjuar ndaj medresesë së mesme të “Alaudinit” në Prishtinë. Shkollimi i shqiptarëve edhe në këto shkolla fetare ishte shumë i kufizuar. Maqedonija si republikë; kohë; nuk kishte medrese dhe unë, kuptohet edhe të tjerët, shkollimin e mesëm fetar e bëmë në Prishtinë.

Gjatë shkollimit tonë në medrese hetonim padrejtësia që bëhesh në të gjitha kuptimet. Për rastin do të përmendi padrejtësinë e numrit të nxënësve që duhej të regjistrohen në medrese. Mbase për vitin e parë mund të paraqitej numër I madh I nxënësve, mirëpo, aty mund të regjistrohej vetëm në paralele dhe kështu p. sh. në vitin shkollor 1967/68 kur uinë u regjistrua në medrese në vitin e parë në një klasë kemi qenë 52 nxënës. Ky numër ishte si rezultat i padrejtësisë që na bëhej vetëm si shqiptar. Në kuptimin e zhvillimit të procesit mësimor, arsimtarët tonë duhej që të na diktonin e ne të shkruajmë gjatë orës ose jashtë mësimit mësimet sepse na mungonin tekstet mësimore, kjo nuk ishte në medresenë e Sarajevës?! Në lëndët e përgjithshme mësonim mësimet të censuruara nga sistemi sepse ashtu duhesh. Sa p.sh. këtu do të përmendi një rastin tim. Isha në vitin e katërt në medrese dhe profesori I gjuhës shqipe na dha të lexojmë nga një lektirë shkollorë sipas dëshirës. Mua më ranë dorë libri, për atëherë i ndaluar “Gjarçijt e gjakut” të Adem Demaçit. E përgadita lektyrën në formë të shkruar dhe e lexova në orën e mësimit. Pasi përfundoi ora, profesori më mori për krahu, si me qenë shok, dhe duke ikur për në sallën e arsimtarëve, pasi kuptoi se si e kam siguruar librin më tha:

“Këtë libër zhduke, pra zhduke edhe shkrimin që ke bërë për lektyrën shkollorë. Përndryshe mund të keshë telashe, të lutem t’i zhdukish!”

Dhe unë kuptohet se i zhduka, kurse librin ia ktheve shokut. Pra, mendoj se vetëm nga ky rast shihet se në çfarë rrethanash dhe kushtesh kemi mësuar. Këtu nuk dua të përmendi rastet tjera në kuptimin përmbajtësor dhe konceptual të mësimet që i mësonim në lëndë të ndryshme si në histori, gjeografi, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi serbo-kroate etj.

Këtë që e përmenda gjër më tani do e përfundoja shkurtimisht se shkollimi i jonë ka qenë nën diktatin e shtetit në të gjitha kuptimet, pra edhe mësonim në medrese. Tekstet mësimore të lëndëve të përgjithshme ishin të ideologjizuara, pra kuptohet antikombëtare e antifetare, sepse ashtu duhej të përgaditen kuadrat e ardhme.

Për sa i përket aspektit teknik të shkollave, rrespektivisht të medresesë, kuptohet se edhe në këtë kuptim ne kishim pengesa dhe mungesa nga më të ndryshmet.

Klasëve të shqiptarëve u mungonin shkumësi, e të mos flasim për mjetet tjera didaktike për ta zhvilluar mësimin.

Nisur nga kjo shqiptarët e Maqedonisë shkollimin e tyre sipëror e bënë në Prishtinë ku tanimë veç ishte hapur Univerziteti i Prishtinës, kuptohet me një numër të reduktuar të fakulteteve dhe të degëve siç quheshin atëherë. Shkonim në Prishtinë sepse në Maqedoni nuk kishte fakultete në gjuhën shqipe në përjashtim të Degës së gjuhës dhe letërsisë që vepronte në suaza të Fakultetit filologjik në Shkup. Krahas kësaj, shqiptarët shkolloheshin, kryesisht në Univerzitetin e Zagrebit dhe të Lubjanës sepse këta dy popuj ndaj shqiptarëve kishin qëndrime më të buta.

Politika kadrovike, gjithashtu ishte nën kontrollin absolut të shtetit. Rrjedhimisht, mësuesit shqiptarë detyroheshin që në të shumtën e rasteve të veprojnë kundër ndjenjave kombëtare, përndryshe ata do të përjashtoheshin nga puna. Presioneve të këtij lloji, mësuesit e të gjitha niveleve përpiqeshin që t'ju rezistojnë, kuptohet secili në formën e vet. Mësuesit kishin presione edhe ndaj qëndrimit të tyre që fshehurazi e bënë në arsimimin e muslimanëve. Presionet ishin më të mëdha tek shqiptarët se sa te pakicat kombëtare, siç quheshin atëherë. Kuptohet se ata nuk ishin në gjendje që të bëjnë ndonjë ndryshim ose presion politik në qarqet e Partisë Komuniste. Me një fjalë, këtu më duhet të përmendi se mësuesit detyrimisht duhej që të dëshmojnë se jasnë kundër ndjenjave kombëtare e fetare, se ata janë të mësuar dhe të përgaditur që të zhvillojnë vëllazrim-bashkimin e popujve dhe të pakicave kombëtare. Në mesin e atyre kishte edhe të atillë që përpiqeshin që në mënyrë të fshehtë që të kultivojnë këto ndjenja tek gjeneratat e reja.

## *2. Si trajtoheshin mësimdhënësit dhe prijësit fetar në kohën e komunizmit?*

**B. Aliu:** mësimdhënësit dhe prijësit fetar që përpiqeshin të gjallërojnë ndjenjat kombëtare e fetare trajtoheshin shumë keq. Kuptohet se Kuvendet partiake lokale, komunale, republikane dhe pastaj ato Federative merrnin masa represive ndaj atyre dhe i kualifikonin si armiq të popullit, si revizionist, nacionalist, shovenist etj. Kurse pas vitit 1981 këtij fjalori i shtuan edhe nocionet: separatist, secesionist, disident etj. Pra, varësisht nga sjellja e mësuesëve dhe hoxhollarëve ashtu edhe i dënonin. Për atë që përjetuan intelektualët e asaj kohe pavarësisht se çfarë ideologjie kanë pasur, besoj se shkrimtarë dhe studijues të ndryshëm kanë shkruar për disa portrete, por këtu me keqardhje më duhet të potencoj se shumë pakë kanë shkruar për hoxhollarët si p.sh. për Bedri Hamitin, njeriu mbase i parë që kthehet me diplomë të Univerzitetit të Az'harit prej Kajros dhe për disa dekada ka udhëqur Bashkësinë Islame Shqiptare, pastaj edhe të Republikës së Maqedonisë. Për hoxhollarët të cilët vuajtën dënimet në burgun famkeq të Goli Otokit, të burgut të Pozharevcit, të burgut të Idrizovës etj.

Për këtë bisedë detyrimisht më duhet të përmendi se ka pasur edhe prej atyre që pushteti i detyronte që të përcjellin shokët e vet dhe më pastaj të shkruajnë për

veprimet e tyre “antishtetërore.” Por, ka pasur edhe të atillë që nuk kanë pranuar detyrat e këtilla dhe ata kanë përfunduar shumë keq.

*3. A mundë ta përshkruani arsimin shqip para dhe pas pavarësisë së Maqedonisë, dhe si ndikonte politika në arsim?*

**B. Aliu:** arsimi tek shqiptarët para pavarësisë së Maqedonisë ka qenë krejtësisht i varur nga programet mësimore që i përpilonte pushteti; prej pushtetit qendror e deri te ai komunal. Këtë politik e bënte një herë në katër vite Kongresi i Partisë Komuniste prej ku edhe caktoheshin detyrat dhe orientimet kryesore për çdo lëmi të jetës shoqërore, pra edhe të arsimit. Me që ploitika shtetërore bënte programet mësimore, kuptohet se çka mund të pritej për arsimin në shqip. Mirëpo, këtu do të përmendi se me ndryshimin e Kushtetutës në vitin 1974 me sa duket sado pak arsimi në gjuhën shqipe u lirua nga prrangat antishqiptare. Mirëpo, në fund të viteve të tetëdhjeta, politika antishqiptare arriti kulmin e vet dhe si duket ky, kuptohet edhe politika e punësimit dhe e jetës së përditshme, ishte shkaku që viti 1990 të shpallet si vit i stabilitetit ekonomik. Por, në kuptimin politik eskaloi shumë dhe kështu, përfundoi sundimi i komunistëve.

Pas pavarësisë së Maqedonisë, shqiptarët menduan se do të marin pjesën që u takon?! Por, fatkeqësisht ndodh e kundërta. Shqiptarët e Maqedonisë së re vazhdojnë të jenë të përndjekur, mbase dhe më shumë se sa në sistemin komunist me një dallim shumë të vogël dhe ai ishte se shqiptarët si të gjithë qytetarët tjerë nuk do të ndiqen për akte verbale. Pra, morën të drejtën e të folurit, “lirinë e të menduarit”, “Lirinë e të shprehurit”, por për mendimin tim këto na kushtuan edhe më shtrenjtë gjatë viteve në vijim. Këtë do e argumentoj me paralelet e përziera që ishin si eksperiment i z. Savo Klimoskit që ishte Ministër i arsimit, me sa më duket menjëherë pas pavarësisë së Maqedonisë. Çka ishin paralelet e përziera?

Ato ishin klasët mësimore ku do të regjistroheshin edhe shqiptarët që krahas me maqedonasit që të shkollohen sepse paralelet në gjuhën shqipe vazhdojnë të jenë të reduktuara. Kjo bëhej me qëllim që shqiptarët të mos asrsimohen në numër. Fatkeqësisht, politika e arsimit të shqiptarëve, për mendimin tim, vazhdon të jetë nën mbikqyrjen absolute të pushtetit dhe sot si duket kësaj i ndihmojnë edhe vetë qartqet e caktuara shqiptare në emër të demokratizimit të shoqërisë, pavarësisht se në cilën dekadë ka ndodhur.

Këtë që e përmenda, kujtoj se e gjeni në vetë tekstet mësimore të të gjitha cikleve të arsimit në gjuhën shqipe sa për shembul po përmendi:

- Në kuptimi kombëtar, shqiptarët vazhdojnë të lexojnë në tekstet mësimore se shqiptarët janë popull i egër, se ata janë të ardhur dhe kanë migruar nga Shqipëria, se ata feja i meson që të mos pranojnë të tjerët pranë vetes etj.

- Në kuptimin shkencor, tekstet e shqiptarëve vazhdojnë të jenë të përkthyer nga njerëz të “zgjedhur” të pushtetit, pavarësisht se çfarë cilësie ka përkthimi,
- Në shkencën e biologjisë vazhdojmë ende të mësojmë teorinë e famshme të Darvinit. Keni parasysh se kjo teori tani besoj se as që përmendet diku në botë,
- Mjetet mësimore në klasët e shqiptarëve vazhdojnë të jenë: shkumsi, fshisa e drrasës së zezë dhe disa mjete të shekullit XIX,
- Tek shqiptarët vetë shkollat duhet të sigurojnë mjete të reja mësimore,
- Mësimdhënësit me sa më duket mua nuk i plotësojnë as për së afërmi kriteret e mësuesit etj.

*4. Mendimi Juaj personal, si ndikon Politika sot në sistemin arsimor duke filluar nga shkollat fillore deri në atë sipërore?*

**B. Aliu:** Politika në arsim sot ndikon shumë keq. Fatkeqësisht, ne sot jemi dëshmitar se politika ditore më së shumeti, mbase diskutohet te nxënësit e shkollave dhe fakulteteve se sa në qarqet tjera. Këtë me sa duket e ndihmon ndryshimi i shpesht i kuadrit arsimor, i cili caktohet nga qarqet e ndryshme, të themi partiake, dhe nuk merren parasysh kriteret shkencore, pedagogjike e arsimore.

Si element tjetër negativ që më duhet të përmendi është edhe ardhmëria e kuadrove të reja që do të jenë të shkolluara! Pra, nuk do ishte e rastit nëse dëgjojmë nga të rinjtë se më mirë të udhtojnë për në Perëndim ku do të punësohet dhe të krijoj kushte më të mira për jetë se sa të shkollohet me që nuk i dihet ardhmërisë. E tërë kjo është përgjigje ndaj politikës që po na e bën pushteti për brezat që vijnë, por këtu mund të përgjithësohet në ditët e sodit, pavarësisht kombin dhe fenë.

Mendoj se është koha që shkollat të vetëdisohen dhe ata që pretendojnë se punojnë për edukimin dhe arsimimin e gjeneratave të reja, t’ju përkushtohen pakë më tepër atyre, pra gjeneratave të reja.